VENDIM
Nr.6, datë 20.1.2010

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "HIDROINVEST 1" SHPK ME SERI PV08K, NR.66, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.113, DATË 24.09.2008

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 15, pika 4, germat "a" dhe "b" të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Hidroinvest 1" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.66, seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hidroinvest 1" sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.87, datë 10.11.2009.
- Është paraqitur i plotë dokumentacioni për këtë procedurë siç kërkohet nga "Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave",

VENDOSI:

1. Të ndryshojë licencën me numër nr.66, seria PV08K, aneksi A, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008, të mbajtur nga shoqëria "Hidroinvest 1" sh.p.k.
2. Kapaciteti i instaluar i HEC Stranik bëhet 4600 kW. Kapaciteti i instaluar i HEC Zall Tore bëhet 3000 kW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta